

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PRISHTINË

Numri i lëndës: PA-II-KZ-II. 7/15
Data: 26 nëntor 2015
Gjykata Themelore: Prizren, P. Nr. 171/2013

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant, si kryetare e kolegjit, gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, dhe gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta, si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Adnan Isufi, këshilltar ligjor i EULEX-it, në cilësi të procesmbajtësit,

në lëndën penale kundër të pandehurve:

PM

SP

AA

KU

AT

MK

Të dënuar me aktgjykim të Gjykatës Themelore të Prizrenit, të datës 13 mars 2014, për veprat penale në vijim:

RM

[REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në vazhdimësi (pikat 1 deri 4) dhe pjesërisht në bashkëkryerje (pikat 2 deri 4), në përputhje me nenin 422, paragrafin 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tuje "KPRK");

SP

[REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tuje KPK) lidhur me nenin 23 të KPRK-së (pika 3);

AA

[REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 422 paragrafit 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (pika 2);

KU

[REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të nenit 422 paragrafit 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së (pika 1);

AT

[REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 25 të KPK-së (pika 4);

MK

[REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje në përputhje me nenin 422, paragrafin 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së;

pas pranimit të ankesës së paraqitur nga Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës, të datës 4 shtator 2015, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të lëshuar më 22 korrik 2015 me të cilin është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda është kthyer në rigjykim,

TG

RM

pas shqyrtimit të përgjigjes së avokatit mbrojtës [REDACTED] në emër të të pandehurit [REDACTED] dhe të përgjigjes së avokatëve mbrojtës [REDACTED] dhe [REDACTED] në emër të të pandehurit

MK

BN

PP

[REDACTED] pas këshillimit dhe votimit më 1 dhjetor 2015;

duke vepruar në përputhje me nenet 412 (6), 412 (1), 416 (2) dhe 398 (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tuje "KPP");

me shumicë votash lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. Ankesa e paraqitur nga Prokurori i Shtetit i Republikës së Kosovës, të datës 4 shtator 2015, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të lëshuar më 22 korrik 2015, pranohet.
2. Aktvendimi i apeluar anulohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim nga një trup i ri gjykues.

Arsyetimi

I. HISTORIA E PROCEDURËS

1. Më 15 shtator 2011, ka nisur hetimi kundër [REDACTED] dhe [REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje KPK). [RM] [NK] [SP] [AA] [KU] [AA] [AT]
2. Më 29 shtator 2011, prokurori lëshoi edhe një aktvendim mbi nisjen e hetimit kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të nenit 339 të KPK-së. [RM]
3. Më 14 nëntor 2011, ka nisur hetimi i tretë me aktvendimin e prokurorit kundër të pandehurit [REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të nenit 339 të KPK-së. [RM]
4. Pas kërkesës së prokurorit, më 18 nëntor 2011, kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit lëshoi aktvendimin me të cilin u vendos të zhvillohet një procedurë e përbashkët për të tre hetimet. [AA] [KU] [AT] [MK] [RM]
5. Më 27 shkurt 2013, prokurori ngriti aktakuzë kundër të pandehurve [REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të nenit 422 të KPK-së, për katër veprat e specifikuar në aktakuzë. [SP]
6. Më 25 mars 2013, u mbajt shqyrtimi fillestar në prani të të pandehurve, të avokatëve mbrojtës dhe të prokurorit. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 13 gusht 2013. Pas 29 seancave të mbajtura, më 13 mars 2014 trupi gjykues shpalli aktgjykimin.

RM

7. Gjykata e shkallës së parë shpalli të pandehurit fajtorë për kryerje të këtyre veprave penale: i pandehuri [REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në vazhdimësi (pikat 1 deri 4) dhe pjesërisht në bashkëkryerje (pikat 2 deri 4), në përputhje me [REDACTED] [SP] nenin 422, paragrafin 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tash e tuje "KPRK"); [REDACTED] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tuje KPK) lidhur me nenin 23 të KPRK-së (pika 3); [REDACTED] [AA] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 422 paragrafit 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (pika 2); [REDACTED] [KM] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të nenit 422 paragrafit 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së (pika 1) [REDACTED] [AT] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 25 të KPK-së (pika 4) ; dhe [REDACTED] [MK] për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje në përputhje me nenin 422, paragrafin 1 dhe 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së. [RB]

8. Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur avokatëve mbrojtës [REDACTED] [BS] [SB] [SP] [RB] në emër të të pandehurit [REDACTED] në emër të të pandehurit [REDACTED] [RH] në emër të të pandehurit [REDACTED] në emër të të pandehurit [REDACTED] [KL] [REDACTED] në emër të të pandehurit [REDACTED] dhe avokati mbrojtës [REDACTED] [PP] dhe [REDACTED] në emër të të pandehurit [REDACTED] [AT] [MK]

9. Më 22 korrik 2015, Gjykata e Apelit me shumicë votash pranoi ankesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës, anuloi aktgjykimin e apeluar të Gjykatës Themelore dhe e ktheu lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim. Gjykata e Apelit gjeti këto shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale të bëra nga gjykata e shkallës së parë:

- Shkelje të nenit 370 (1) dhe (2) të KPP-së sepse aktgjykimi i kundërshtuar kishte mungesë të disa elementeve të domosdoshme të përcaktuara me ligj sikurse: emri dhe mbiemri i procesmbajtësit, e dhëna se a ishin të pandehurit të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, emri dhe mbiemri i prokurorit të shtetit, emrat e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve, dhe data e përpilimit të aktgjykimit;¹

¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, 22.07.2015, PAKR 349/14, p. 21-22

- Shkelje të nenit (1.12) në lidhje me nenin 370 (6) dhe (7) të KPP-së për shkak të faktit se dispozitivi ishte i pakuptueshëm, i paqartë dhe në mospërputhje me arsyetimin dhe me faktet vendimtare të paraqitura nga gjykata e shkallës së parë; veçanërisht ishte e paqartë se cilat fakte dhe veprime ishin përcaktuar nga Gjykata Themelore me cilat prova pasi nuk kishte asnjë përshkrim faktik që do të mund t'i sqaronte veprimet specifike inkriminuese të të akuzuarve;²
- Shkelje të nenit (1.12) në lidhje me nenin 370 (8) të KPP-së pasi aktgjykimi nuk ka përmendur rrethanat që gjykata i ka marrë parasysh në përcaktimin e dënimit³

Gjykata e Apelit arriti në përfundim se aktgjykimi i apeluar i Gjykatës Themelore ishte juridikisht i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashur të anulohet. Prandaj, lëndë është dashur të kthehet në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim. Në procesin e rigjyimit, Gjykata Themelore ka për detyrë t'i eliminojë të gjitha shkeljet e lartpërmendura, t'i administrojë të gjitha provat dhe t'i vlerësojë ato në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 6, 7 dhe 8 të KPP-së, dhe pastaj varësisht nga vlerësimi i këtyre provave të arrijë përfundime të drejta dhe të ligjshme të bazuara në provat e administruara para marrjes së vendimit të duhur.⁴

Në përfundim, Gjykata e Apelit tregon se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të paraqesë asnjë rrethanë lehtësuese apo rënduese, dhe prandaj kolegji nuk ishte në gjendje të pajtohet apo të mos pajtohet me dënimin. Për këtë arsye ishte pranuar ankesa, aktgjykimi shkallës së parë u anulua dhe lënda u kthye për rigjykim.

Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nuk përmban asnjë sqarim pse kjo gjykatë nuk ka proceduar me këtë lëndë sipas nenit 403 të KPP-së.

10. Në përputhje me nenin 398 paragrafin 4 të KPP-së, kryetari i kolegjit dhe gjyqtari referues ka paraqitur mendim mospajtues ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Ai ka sqaruar pse nuk është pajtuar me shumicën e kolegjit.
11. Më 4 shtator 2015, prokurori i EULEX-it i Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të datës 22 korrik 2015.
12. Rrjedhimisht ankesa ishte dorëzuar avokatit mbrojtës dhe të pandehurve.

² *ibidem*, f. 22-25

³ *ibidem*, f. 25

⁴ *ibidem*, f. 26

- BN TG PP RM MK
13. Më 8 dhe 9 shtator, avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] dhe avokati mbrojtës [redacted] dhe [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] paraqitën mendimet e tyre mbi ankesën e prokurorit.

II. PARASHTRRESAT E PALËVE

Ankesa e Prokurorit të Shtetit

14. Prokurori kundërshton aktvendimin e Gjykatës së Apelit në bazë të nenit 411 paragrafit 1 nën-paragrafëve 1.1, 1.2, 1.4 të KPP-së. Sipas ankesës, aktvendimi shkel: të drejtën e palës të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më saktë me nenin 54 të Kushtetutës; të drejtën themelore të palës të përcaktuar me këtë kod, të specifikuar në nenin 7 të KPP-së, dhe të drejtën procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës nga nën-paragrafët 1.1 to 1.3 të këtij neni, të specifikuar në nenin 404 paragrafin 1 të KPP-së.
15. Sa i përket pranueshmërisë së ankesës, prokurori parashtron se neni 411 paragrafi 6 i KPP-së e autorizon palën të paraqesë ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Paragrafët 6 deri 11 të po këtij neni përcaktojnë se si të procedohet me ankesat kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit. Prokurori prandaj pretendon se ankesa është e lejueshme dhe i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të vendosë mbi meritat e saj.
16. Prokurori i Shtetit pohon se Gjykata e Apelit nuk ka arritur të sigurojë të drejtën e mbrojtjes juridike atyre palëve të drejtat e të cilëve janë shkelur me anë të veprave penale të të akuzuarve duke anuluar me nxitim aktgjykimin e Gjykatës Themelore në vend që t'i adresojë në përpikëri çështjet e ngritura në ankesa, në përgjigjen e Prokurorit Themelor dhe në propozimin e Prokurorit të Apelit. Sipas prokurorit, Gjykata e Apelit nuk i ka vërtetuar faktet relevante saktë dhe krejtësisht sa të marrë një vendim të ligjshëm. Aktvendimi i apeluar ka gabime në ligj dhe fakte, dhe është i përgjithshëm.
17. Prokurori i Shtetit pohon se Gjykata e Apelit jep vetëm disa udhëzime për gjykatën e rigjykimin, për shembull të identifikohet pala e dëmtuar, të angazhohet një ekspert për vërtetimin e dëmit, të rishikohen dhe vlerësohen dëshmitë e dëshmitarëve, dhe të pastrohet dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimin të shkallës së parë nga shkeljet e vërtetuara nga Gjykata e Apelit.
18. Prokurori i Shtetit pohon se Gjykata e Apelit nuk i ka ekzaminuar individualisht çështjet e ngritura në ankesat e mbrojtjes, e as çështjet që përbëjnë kufijtë e shqyrtimit të ankesës të përcaktuar me nenin 394 paragrafin 1 të KPP-së. Gjykata nuk i ka marrë parasysh as çështjet e

ngritura në përgjigjen e Prokurorit Themelor, dhe në propozimin e Prokurorit të Apelit. Sipas prokurorit, Gjykata e Apelit nuk ka arritur ta adresojë çështjen se a e ka tejkalluar aktakuzën Gjykata Themelore, siç ka pretenduar në ankesën e tij avokati mbrojtës [redacted] për të pandehurin [redacted] ose paragjykimin e trupit gjykues siç është pretenduar në ankesën e përbashkët të avokatëve mbrojtës [redacted] dhe [redacted] për të pandehurin [redacted].

SM

AT

MK

LPP

BN

19. Prokurori parashtron se në përputhje me nenin 371 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, mangësitë përkitazi me formën e aktgjykimit të shkruar, *d.m.th.* emrat e avokatëve mbrojtës dhe të prokurorëve etj., mund të korrigjohen me një aktvendim të veçantë të kryetarit të trupit gjykues pas propozimit të palëve, të avokatëve mbrojtës ose *sipas detyrës zyrtare*. Nëse këto *de minimus* apo gabime të padëmshme të aktgjykimit janë ngritur në ankesë, siç është vërtetuar në këtë rast, po ashtu Gjykata e Apelit mund t'i korrigjojë sipas nenit 403 të KPP-së.

20. Prokurori parashtron se Gjykata e Apelit nuk e ka bazuar qëndrimin e vet në asnjë dispozitë specifike të KPP-së, që ndalon gjykatën e shkallës së parë të bëjë referencë ndaj akuzave të ngritura kundër të akuzuarit në aktakuzë. Prokurori pohon se përshkrimi i fakteve në aktakuzë dhe vërtetimi i fakteve në dispozitiv të aktgjykimit mund të dallohet qartazi, si dispozitivi ashtu edhe arsyetimi i aktgjykimit qartë konstatojnë faktet dhe provat që ndodhen aty, si dhe veprimet për të cilat të akuzuarit ishin shpallur fajtorë nga Gjykata.

21. Sa i përket vëllimit të dëmeve dhe vlerës së përfitimit material, prokurori pohon se përfitimi material apo dëmi nuk është element i veprës penale për të cilën janë akuzuar të pandehurit. Atë çfarë kërkon neni 422 i KPK-së është vetëm qëllimi specifik që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkelë të drejtat e personit tjetër. Më tutje, sa i përket të pandehurve [redacted] dhe [redacted] prokurori pohon se element i veprës penale është dëmi apo shkelja e rëndë e të drejtave të personit tjetër (rezultatet e veprës penale) dhe jo përfitimi material.

SP

AT

Përgjigja e avokatit mbrojtës:

TG

BN

PP

22. Avokatët mbrojtës [redacted] dhe [redacted] parashtruan se ankesa e prokurorit të shtetit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit është paligjshme, dhe njëkohësisht e papranueshme. Avokatët mbrojtës [redacted] dhe [redacted] pohuan se neni 407 i KPP-së parashkruan rastet kur mund të paraqitet ankesë kundër vendimit të lëshuar Gjykata e Apelit. Avokati mbrojtës i propozoi gjykatës që ta refuzojë ankesën si të palejueshme.

BN

PP

III. GJETJET E KOLEGJIT

Pranueshmëria e ankesës

Vërejtjet e përgjithshme

23. Çështja preliminare për t'u vendosur në këtë lëndë është se a lejohet fare ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Rishtazi është përdorur një praktikë e dykuptimshme gjyqësore lidhur me këtë çështje, prandaj është e domosdoshme të bëhet një analizë e thuktë e ligjit në fuqi.
24. Në përputhje me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kushtetuta është akti më i lartë juridik në vend, dhe ligjet e aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë, dhe të interpretohen në përputhshmëri (Epërsia e Kushtetutës). Në nenin 102 (5) Kushtetuta përcakton parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor: e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor garantohet, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. Në parim ankesë mund të paraqitet ndaj çdo vendimi gjyqësor, dhe përjashtimet nga kjo rregull e përgjithshme duhet të përcaktohen saktë me ligj.
25. Për shkak të epërsisë së Kushtetutës, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale duhet të interpretohen në përputhje me këtë akt më të lartë juridik.
26. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës nuk përcakton qartë nëse procedurat janë në dy apo tre instanca. Prandaj, sipas nenit 102 (5) të Kushtetutës, ankesë mund të paraqitet ndaj çdo vendimi gjyqësor të lëshuar gjatë procedurës penale, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe.
27. Llojet e mjeteve juridike në procedurë penale janë listuar në nenin 374 të KPP-së, i cili përcakton:
 1. Përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, pala mund të paraqesë mjetin juridik në gjykatën e shkallës drejtpërdrejtë më të lartë përmes:
 - 1.1. ankesës kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.
 - 1.2. ankesës kundër aktgjyqimi të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës sipas paragrafit 1. të nenit 407 të këtij Kodi ose kur me aktgjykim shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm.
 - 1.3. ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.

1.4. kërkesës për mjetin e jashtëzakonshëm juridik nga Gjykata Themelore apo Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

2. Kur lejohet me këtë Kod, urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake mund të shqyrtohet nga kolegji i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve të gjykatës themelore. Urdhri i shqyrtuar nga kolegji shqyrtues nga ky paragraf mund të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit apo Gjykata Supreme vetëm me rastin e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore.

Siç edhe rezulton qartë nga shprehja "Përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod", ky nuk është katalog i mbyllur i mjeteve juridike.

28. Neni 408 (1) i KPP-së shprehimisht tregon llojet e aktvendimeve që mund të ankimohen. Ky nen përcakton se:

"Kundër aktvendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, në pajtim me nenin 411 të këtij Kodi mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë."

29. Në paragrafët pasues, neni 408 i KPP-së përcakton këto parime kur nuk lejohet ankesë kundër aktvendimit:

- të marrë në procedurë paraprake nga kolegji shqyrtues i përbërë nga tre gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe (neni 408 (2) i KPP-së);
- që merret për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të aktgjykimit, përveç kur ky Kod parasheh ndryshe (neni 408 (3) i KPP-së);
- të Gjykatës Supreme (neni 408 (4) i KPP-së).

30. Kodi po ashtu definon instancat specifike kur nuk lejohet ankesë ndaj vendimit gjyqësor. E këto raste janë:

- ndaj aktvendimit me të cilin caktohet bashkimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për bashkim (neni 35 (8) i KPP-së);
- ndaj aktvendimit me të cilin lejohet veçimi i procedurës ose refuzimi i propozimit për veçimin e procedurës (neni 36 (3) i KPP-së);
- ndaj urdhrit për kompetencën e deleguar dhe bartjes së juridiksionit (neni 37 (6) i KPP-së);

- ndaj aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit (neni 42 (3) i KPP-së);
 - kundër aktvendimit me të cilin hedhet poshtë kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit (neni 42 (4) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit për shkarkimin e mbrojtësit (neni 59 (3) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit për rregullim të kontabilitetit (neni 148 (5.2) i KPP-së);
 - ndaj vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për lejimin e inspektimit, kopjimit ose fotokopjimit (neni 213 (7) i KPP-së);
 - ndaj vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake kundër mohimit të prokurorit të shtetit për ta lejuar palën e dëmtuar t'i shikojë shkresat e lëndës (neni 214 (3) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit që i mohon mbrojtësit ose përfaqësuesit të autorizuar të drejtën për të mbrojtur ose përfaqësuar klientët e tyre në shqyrtim gjyqësor kur pas dënimit ata vazhdojnë të prishin rendin, lidhur me ndërprerjen apo shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor (neni 302 (3) i KPP-së);
 - ndaj vendimeve lidhur me mbajtjen e rendit dhe drejtimin e shqyrtimit gjyqësor, ndryshe nga aktvendimi për dënimin (neni 303 (1) (2) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit me të cilin shtyhet shqyrtimi gjyqësor (neni 310 (2) i KPP-së)
 - ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit për vazhdimin apo heqjen e paraburgimit kundër të akuzuarit (neni 402 (4) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit për caktimin ose heqjen e paraburgimit kundër të akuzuarit (neni 403 (3) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit me të cilin lejohet *kthimi në gjendje të mëparshme* (neni 448 (2) i KPP-së);
 - ndaj aktvendimit të trupit gjykues për masat e përkohshme të sigurimit të kërkesës pronësore (neni 467 (3) i KPP-së).
31. Përveç kësaj, në nenin 432 (2) Kodi përcakton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, nuk mund të ushtrohet kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Ligjbërësi e ka konsideruar si të domosdoshme ta rregullojë qartë se vendimi i Gjykatës Supreme mbi këtë

çështje nuk mund të kundërshtohet. Prapë ekziston një përjashtim nga ky përgjithësim i cili është përcaktuar me nenin 432 (3) të KPP-së.

32. Në krahasim, me përjashtimin e përgjithshëm duke iu referuar vendimeve të Gjykatës Supreme asnjëra prej të cilave nuk mund të ankimohen (neni 408 (4) i KPP-së), në parim as kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër tyre kundër tyre nuk lejohet (neni 432 (2) i KPP-së), Kodi nuk përmban një rregull të ngjashme për vendimet e lëshuara nga Gjykata e Apelit. Kjo qon në përfundim se në mungesë të ndalesës specifike, mbizotëron parimi i përgjithshëm kushtetues, dhe palët lejohen të paraqesin ankesë kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit.⁵
33. Kodi po ashtu përcakton një procedurë specifike për ta fuqizuar të drejtën e ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit i cili në fund vendoset nga Gjykata Supreme (neni 411 dhe 412 i KPP-së). Nëse ankesat ishin të ndaluara këto dispozita do të ishin të tepërta. Kjo e fundit do të ishte në kundërshtim me supozimin se ligjbërësi është racional.
34. Mbrojtja e të drejtave kushtetuese është me rëndësi jetike pasi Kodi lejon rishikim të apelit edhe për ankesa që nuk janë në pajtim me Kapitullin XXI të saj, kur ngrihet ndonjë çështje e rëndësishme lidhur me të drejtat kushtetuese të garantuara (neni 411 (9) i KPP-së).

Pranueshmëria e ankesës në kontekst të formës së vendimit

35. Analiza e Kodit qon deri në përfundim se ka vendime për çështjen materiale të lëndës (*meritat*) dhe vendime të tjera. Vendimet mbi *meritat* e lëndës penale i referohen çështjeve të fajësisë dhe të dënimit (neni 1 (2) i KPP-së). Të gjitha vendimet e tjera që i merr gjykata gjatë zhvillimit të procedurës janë zakonisht të natyrës përgatitore apo procedurale. Këto të parat i referohen veprimeve të domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale, siç është sigurimi i provave, (*p.sh.* përmes vëzhgimit), pranimi i provave, zbatimi i masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit, ngrirja e asetëve, zhvillimi i procedurës penale etj. Përveç kësaj, gjykata merr shumë vendime pikërisht të karakterit procedural: *p.sh.* gjykata përcakton përbërjen e kolegjit, cakton dhe shtyn shqyrtimet gjyqësore, ose vendos mbi pranueshmërinë e mjeteve juridike.
36. *Meritat* e lëndës penale vendosen nga gjykata me aktgjykim pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Në parim, procedurat e apelit kundër aktgjykimit janë dy – instanca pasi që ndaj çdo aktgjykimi të Gjykatës Themelore mund të paraqitet ankesë pranë Gjykatës së Apelit.
37. Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, në formë të aktgjykimit merr vendimet në vijim:

⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 26 nëntor 2015, PN.II. 8/2015

- Aktgjykim me të cilin refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton aktgjykimin e Gjykatës Themelore (Neni 401 i KPP-së);
- Aktgjykim me të cilin ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve (Neni 403 (1) i KPP-së), ose kur ekzistojnë kushtet ligjore për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore (Neni 403 (2) i KPP-së);
- Aktgjykim me të cilin refuzon ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore me të cilin aktakuza është hedhur poshtë (Neni 416 (3) i KPP-së).

38. Gjykata e Apelit, në formë të aktvendimit merr vendimet në vijim:

- Aktvendim mbi ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore me të cilin ankesa është hedhur poshtë si e paafatshme ose e papranueshme (Neni 416 (2) i KPP-së);
- Aktvendim mbi ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore kur ankesa është aprovuar dhe aktvendimi është ndryshuar ose anuluar dhe sipas nevojës është kthyer në rishqyrtim (Neni 416 (2) i KPP-së);
- Aktvendim me të cilin ankesa kundër aktgjykimit është hedhur poshtë si e paafatshme (Neni 399 i KPP-së);
- Aktvendim me të cilin ankesa kundër aktgjykimit është hedhur poshtë si e palejueshme (Neni 400 i KPP-s.);
- Aktvendim me të cilin aktgjykimi i Gjykatës Themelore është anuluar dhe lënda është kthyer në rigjykim (Neni 402 (1) i KPP-së);
- Aktvendim me të cilin aktgjykimi i Gjykatës Themelore është anuluar dhe aktakuza është refuzuar për shkak të rrethanave të specifikuar në nenin 358 (1) të KPP-së (Neni 402 (2) i KPP-së).

39. Ekzistojnë tri situata kur Kodi përcakton se kur Gjykata e Apelit vendos mbi ankesën me aktgjykim. Dy të parat janë të qarta pasi që i referohen situatës kur Gjykata Themelore ka vendosur mbi meritat e lëndës penale: Gjykata e Apelit konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë duhet të vërtetohet (1), ose duhet të ndryshohet (2). Në situatën e tretë, Gjykata e Apelit vendos me aktgjykim se aktvendimi i Gjykatës Themelore me të cilin është hedhur poshtë aktakuza duhet të vërtetohet (3).

40. Në situatën kur vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore mbi hedhjen poshtë të aktakuzës, Gjykata e Apelit nuk vendos mbi *meritat* e lëndës penale në atë kuptim se nuk përcakton nëse është kryer vepra penale, dhe nëse po, nëse i pandehuri do të mbahet përgjegjës për atë. Me aktgjykim, Gjykata e Apelit konfirmon vlerësimin e Gjykatës Themelore se aktakuza është dashur të hedhet poshtë për shkak të rrethanave të përcaktuara në nenin 253 të KPP-së. Do të thotë se Gjykata e Apelit pajtohet me Gjykatën Themelore se:

- Vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
- Ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- Ka kaluar afati i parashkrimit, vepra përfshihet me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen, ose
- Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale.

41. Pasoja për vendimin e lëshuar nga Gjykata e Apelit në formë të aktgjykimit është e konsiderueshme. Ekziston mundësia shumë e kufizuar për të paraqitur ankesë kundër tij pranë Gjykatës Supreme. Në parim, kodi garanton stabilitetin e aktgjykimeve të lëshuara nga Gjykata e Apelit. Prandaj, procedura në shkallë të tretë përcaktohet vetëm në situatat kur:

- Gjykata e Apelit ka shpallur të pandehurin fajtor pas lirimit nga Gjykata Themelore, arsyeshmëria e kësaj zgjidhjeje është për t'ia garantuar të pandehurit të drejtën për ta kundërshtuar shpalljen fajtor për herë të parë në shkallë të dytë;
- Është shqiptuar/vërtetuar burgimi i përjetshëm nga gjykata e shkallës së dytë, për shkak të ndikimit të gjatë në lirinë personale të individit (Neni 407 (1) i KPP-së).

42. Nëse Gjykata e Apelit mbështet aktvendimin e Gjykatës Themelore me të cilin është hedhur poshtë aktakuza, ky vendim në mënyrë të veçantë lëshohet në formë të aktgjykimit. Nuk mund të apelohej, pasi që vendimi i tillë nuk bie në fushëveprimin e nenit 407 (1) të KPP-së. Arsyeja prapa këtij parimi është për ta mbrojtur individin nga aktakuzat e pabaza, pasi që akti i ngritjes së aktakuzës shpeshherë shkakton stigmatizimin e të akuzuarit. Ligjvënësi në mënyrë të qartë ka zbatuar konceptin se nuk ka nevojë që më tutje të shqyrtohet ky vendim me mjete të zakonshme juridike nëse gjykatat e dy shkallëve kanë vendosur se kanë ekzistuar arsye për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe për ndërprerjen e procedurës.

43. Në rast të ankesës kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit vendos me aktvendim në situatat kur:

- Ankesa është e paafatshme (Neni 399 i KPP-së); ose
- Ankesa është e palejueshme (Neni 400 i KPP-së).

Në të dy situatat, pas vërtetimit të këtyre rrethanave, Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh poshtë ankesën.

44. Sipas nenit 402 (1) të KPP-së, Gjykata e Apelit me aktvendim anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe kthen çështjen në rigjykim, nëse:

- ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale; ose
- për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në Gjykatën Themelore.

Në të dy situatat, Gjykata e Apelit patjetër duhet të vërtetojë se nuk është e mundur të procedohet siç është përcaktuar me nenin 403 të KPP-së dhe ta ndryshojë aktgjykimin.

45. Në aktvendimin me të cilin është anuluar aktgjyrimi i shkallës së parë dhe lënda është kthyer në rigjykim, Gjykata e Apelit nuk i vlerëson *meritat* e lëndës penale në kuptimin e sqaruara më lart. Në situatën e përcaktuar në nenin 402 (1.1) të KPP-së, gjykata vërteton se gjatë procedurës para Gjykatës Themelore ka ndodhur shkelje substanciale e procedurës penale sipas nenit 384 të KPP-së. Kur lënda kthehet në rigjykim sipas nenit 402 (1.2) të KPP-së, Gjykata e Apelit konstaton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ose jo të plotë. Në të dy situatat, gjykata patjetër duhet të vërtetojë se gjatë procedurës së apelit nuk ka qenë e mundur të korrigjohen aktgjykimet e Gjykatës Themelore.

46. Interpretimi i nenit 402 (1) i lexuar së bashku me nenin 403 të KPP-së çon në përfundim se vendimi për ta kthyer lëndën në rigjykim duhet të merret vetëm në rrethana të veçanta kur Gjykata e Apelit nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin. Një qasje e tillë është në përputhje me parimin e gjyimit të drejtë, i cili gjithashtu përmban obligimin që lënda të vendoset brenda afatit të arsyeshëm kohor, pa vonesa⁶. Çdo rigjykim e zgjat procedurën penale dhe prolongon marrjen e vendimit të prerë, i cili shpeshherë është kundër interesit të palëve, në veçanti të pandehurit, i cili ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.

⁶ Stögmüller kundër Austrisë [1969] ECHR 25, par. 5 (nën titullin "Sa i përket ligjit"); dhe Komisioni I K8 për të Drejtat e Njeriut, CCPR Komenti i Përgjithshëm 32 (2007), par. 35.

Gjithashtu, është edhe kundër interesit publik. Qëllimi i kësaj mbrojtjeje, i cili përfaqësohet i referohet maksimisht së popullarizuar "drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar", për t'iu shmangur mbajtjes së personave në gjendje të pasigurisë duke i mbrojtur të gjitha palët e procedurës gjyqësore kundër vonësve procedurale të tepruara, të cilat mund ta rrezikojnë efektivitetin dhe kredibilitetin e administrimit të drejtësisë.⁷ Vonesa kryesisht mund të jetë e dëmshme në lëndën ku i pandehuri është liruar nga Gjykata Themelore, dhe pastaj Gjykata e Apelit e kthen lëndën e tij/saj në rigjykim. Probabiliteti i shkeljes së të drejtës në gjykim të drejtë brenda afatit të arsyeshëm kohor rritet në mënyrë drastike.

47. Gjykata Supreme thekson se mjeti juridik patjetër duhet të jetë efektiv. Nëse gjykata i shmanget marrjes së vendimeve, mbrojtja gjyqësore e mbrojtjes procedurale bëhet iluzion⁸. Interpretimi i tillë mbështetet më tutje me nenin 54 të Kushtetutës i cili përcakton se:

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

48. Neni 402 (2) i KPP-së përcakton se Gjykata e Apelit me aktvendim e anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe refuzon aktakuzën nëse konstaton rrethanat nga neni 358 (1) të KPP-së në vijim:

- procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të shtetit;
- ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen;
- ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.

49. Në të gjitha situatat kur Gjykata e Apelit vendos me aktvendim mbi ankesën kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore, ajo nuk vlerëson *meritat* e lëndës penale. Gjykata, për shkak të dështimeve dhe shkeljeve të ndryshme procedurale, nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të drejtë nëse vepra penale është kryer, dhe nëse po, nëse i pandehuri do të mbahet përgjegjës për atë.

⁷ H. kundër Francës [1989] GJEDNj 17, par. 58; Bottazzi kundër Italisë [1999] GJEDNj 62, par. 22; Cocchiarella kundër Italisë [2006] GJEDNj 609, par. 119

⁸ Airey kundër Irlandës [1979] GJEDNj 3, par. 24, dhe Artico kundër Italisë [1980] GJEDNj 4, par. 33.

50. Kodi nuk përmban një dispozitë specifike e cila nuk lejon ankesë kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit me të cilat është vendosur mbi ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Prandaj, sipas nenit 102 (5) të Kushtetutës, duhet të konstatohet se ankesa lejohet.
51. Çdoherë që Gjykata e Apelit refuzon të vendosë mbi *meritat* e lëndës dhe të shqyrtojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe në vend të kësaj ndërpret procedurës ose e kthen lëndën në rigjykim paraqitet një *arsye e re* (bazë e re për ankesë) për së paku për njërën nga palët. Këta janë disa shembuj të arsyeve të mundshme për të paraqitur ankesë kundër një vendimi të tillë, për të ilustruar argumentimin e paraqitur:
- a. Në situatë kur ankesa refuzohet mbi bazën e përcaktuar me nenin 399 të KPP-së, pala mund të paraqes ankesë pranë Gjykatës Supreme, duke pretenduar ase ankesa është paraqitur me kohë, por *p.sh.*, jo pranë gjykatës kompetente (Neni 445 (5) i KPP-së);
 - b. Kur Gjykata e Apelit me aktvendim refuzon ankesën si të palejueshme, pala mund të paraqes ankesë pranë Gjykatës Supreme, duke pretenduar se *p.sh.*, ai ose ajo është palë e dëmtuar në procedurë dhe si e tillë është kompetente për të paraqitur ankesë;
 - c. Kur Gjykata e Apelit anulon aktgjykimin dhe me aktvendim e refuzon aktakuzën sipas nenit 358 të KPP-së, pala mund ta kundërshtojë këtë vendim mbi bazën e vërtetimit të gabuar të fakteve nga Gjykata e Apelit sepse *p.sh.*, ka ekzistuar një propozim nga pala e dëmtuar, ose kërkesë nga prokurori kompetent;
 - d. Pala gjithashtu mund të pretendojë se Gjykata e Apelit ka vlerësuar gabimisht ekzistimin e rrethanave të cilat e pengojnë ndjekjen penale (Neni 358 (1.3) i KPP-së). Mundësia për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit mbi këtë bazë është e rëndësishme së veçantë sepse kodi nuk përcakton *numerus clausus* të situatave të cilat e pengojnë ndjekjen penale. Pala patjetër duhet të ketë të drejtë të kundërshtojë vendimet e Gjykatës së Apelit, pasi që përndryshe ai ose ajo do të privoheshin nga e drejta në gjykatë, që është njëra nga garancitë kushtetuese të sundimit të ligjit.

Kufizimi i të drejtës në ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit

52. Fakti i vetëm se Gjykata Supreme gjen se ligji lejon ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit nuk çon në përfundim se kodi i mundëson palëve që të paraqesin ankesë ndaj çdo vendimi në gjykatën e shkallës së tretë. Për ta kuptuar aktvendimin e Gjykatës Supreme në

mënyrë të drejtë është e domosdoshme që nocioni i "vendimit gjyqësor" të interpretohet saktë, siç është përdorë në nenin 102 (5) të Kushtetutës.

53. Interpretimi sistematik i Kodit të Procedurës Penale, i bërë në dritën e parimeve kushtetuese, mundëson që të konstatohet se nocioni i "vendimit gjyqësor" nuk duhet të interpretohet në mënyrën formale, mirëpo nga këndvështrimi i qëllimit i cili duhet të arrihet nga gjykata. Prandaj, duhet të zbatohet interpretimi teleologjik, i cili do të jetë i dobishëm për të gjetur qëllimin e duhur të procedurës së apelit të zbatueshëm nga gjykatat e Kosovës.
54. Kushtetuta i garanton çdo individ të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Neni 31), mbrojtjen gjyqësore dhe mjetin juridik efektiv (Neni 54), dhe ankesën kundër një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe (Neni 102 (5)). Sistemi gjyqësor është në gjendje që individit t'i ofroj mjet juridik efektiv vetëm nëse ekziston një limit i caktuar për mundësinë e ankesës kundër vendimeve gjyqësore. Pa kufizime të procedurës së apelit, sistemi gjyqësor do të bëhej i paqëndrueshëm dhe do të krijonte pasiguri.
55. Gjykata Supreme nënvizon përsëri se qëllimi kryesor i procedurës penale është për të vërtetuar nëse i pandehuri ka kryer veprën penale, dhe nëse përgjigja në këtë pyetje është pozitive, nëse ai ose ajo do të mbahet përgjegjës për këtë vepër. Vendimet e tjera të marra gjatë procedurës penale kanë karakter subsidiar për këtë synim përfundimtar.
56. *Meritat* e procedurës penale mund të ekzaminohen dy herë, fillimisht nga Gjykata Themelore dhe pastaj nga Gjykata e Apelit, në rast se pala paraqet kërkesë për mjet juridik. Në situata të veçanta, të përcaktuara me nenin 407 të KPP-së, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit mund të apelohej pranë Gjykatës Supreme.
57. Lidhur me të gjitha çështjet tjera të vendosura nga Gjykata e Apelit, të ndryshme nga *meritat* e procedurës penale, ekzistojnë disa pyetje të cilat duhet të përgjigjen për të përcaktuar nëse vendimi mund të kundërshtohet në shkallë të tretë. Së pari, është e domosdoshme të gjejmë nëse ekziston ndonjë dispozitë në Kodin e Procedurës Penale e cila në mënyrë strikte e përjashton mundësinë për të paraqitur ankesë kundër vendimit. Së dyti, duhet të bëhet testi funksional, p.sh., është e domosdoshme që të vlerësohet nëse vendimi në fjalë ka adresuar një çështje të re e cila nuk është shqyrtuar nga gjykata e shkallës së parë. Nëse përgjigja është pozitive, atëherë në parim, pala ka të drejtë që kjo çështje të shqyrtohet nga shkalla e dytë.
58. Edhe nëse rezultati i këtij testi është negativ, Gjykata e Apelit/Gjykata Supreme gjatë vendosjes mbi pranueshmërinë e ankesës patjetër duhet patjetër të zbatojnë kriterin përfundimtar i cili në

mënyrë strikte është përcaktuar me nenin 411 (2) dhe (9) të KPP-së. Ankesa mund të hedhet menjëherë vetëm pasi të jenë siguruar se nuk është ngritur ndonjë çështje e rëndësishme e të drejtave të mbrojtura me kushtetutë. Nëse gjykata gjen se bëhet fjalë për një shkelje të tillë, atëherë ankesa lejohet.⁹

59. Duke pasur parasysh testin, *p.sh.*, aktvendimi i Gjykatës së Apelit mbi hedhjen poshtë të ankesës si të paafatshme (Neni 399 i KPP-së) mund të apelohe pranë Gjykatës Supreme, pasi që i referohet një çështjeje të re (nëse mjeti juridik është paraqitur me kohë), dhe pala ka të drejtë që kjo çështje të shqyrtohet në dy shkallë. Në anën tjetër, *p.sh.*, çështja e masës që duhet zbatuar kundër të pandehurit për të siguruar praninë e tij (si paraburgimi), nëse vendoset nga Gjykata Themelore mund të apelohe pranë Gjykatës së Apelit. Nëse Gjykata e Apelit vendos lidhur me pyetjen nëse duhet të zbatohet masa specifike, vendimi i saj nuk mund të kundërshtohet apelohe pranë Gjykatës Supreme. Shqyrtimi i të njëjtës çështje nga gjykatat e dy shkallëve është i mjaftueshëm për të përmbushur kushtet e specifikuar në Kushtetutë.
60. Zbatimi i këtij testi në aktvendimin e Gjykatës së Apelit me të cilat anulohet aktgjykimi dhe lënda kthehet në rigjykim çon në përfundim se mund të apelohe pranë Gjykatës Supreme. Së pari, nuk ekziston asnjë dispozitë e cila përjashton të drejtën në ankesë kundër një aktvendimi të tillë. Së dyti, Gjykata e Apelit në këtë aktgjykim nuk vlerëson *meritat* e lëndës penale, dhe gjen se ekzistojnë shkelje të rënda të cilat nuk mund të korrigjohen gjatë procedurës së apelit. Secila palë, që nuk pajtohet me një vlerësim të tillë të Gjykatës së Apelit, duhet patjetër të ketë të drejtë që ta kundërshtojë atë pranë Gjykatës Supreme.

Përfundimi mbi pranueshmërinë e ankesës

61. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme gjen se ankesa e Prokurorit të Shtetit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të datës 4 shtator 2015, është e pranueshme. Është paraqitur nga pala në këtë lëndë dhe brenda fatit kohor.

Meritat e lëndës

62. Gjykata Supreme ka analizuar në hollësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe aktvendimin e kundërshtuar në dritën e argumenteve të paraqitura nga prokurori në ankesë. Më tutje, Gjykata Supreme ka shqyrtuar mendimin e ndarë mospajtues të kryetarit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, në cilin ka paraqitur argumentimin e tij të gjerë dhe gjithëpërfshirës kundër vendimit të

⁹ Ky kriter përfundimtar së fundmi është zbatuar nga Gjykata Supreme në aktvendimin e datës 26 nëntor 2015, PNII 8/2015, f. 6-7.

shumicës. Në bazë të vlerësimit të kujdesshëm dhe të përpiktë të këtyre dokumenteve, Gjykata Supreme gjen se ankesa e paraqitur nga prokurori i shtetit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit pranohet si e bazuar.

63. Tashmë, siç është cekur më lart, vendimi për anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e lëndë në rigjykim merret vetëm në raste të veçanta, kur vërtetohet se ekzistojnë shkelje të caktuara procedurale, Gjykata e Apelit gjen se nuk mund të procedojë në përputhje me nenin 403 të KPP-së dhe të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit në aktvendim patjetër duhet të paraqes arsyet se pse nuk ka qenë e mundur që të procedohet siç është përcaktuar në dispozitën e përmendur.
64. Gjykata Supreme e konsideron të domosdoshme të nënvizojë se standardi për procedurën e apelit i cili rezulton nga neni 2 të Protokollit 7 të *Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut* kërkon që shqyrtimi nga gjykata e apelit është një vlerësim i plotë dhe i hollësishëm i faktorëve relevant.¹⁰ Siç është përfunduar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk mund të ketë të drejtë të dobishme dhe efektive në ankesë pa një aktgjykim i cili me qartësi të mjaftueshme tregon bazën mbi të cilën është marrë vendimi.¹¹ Vendimet e arsyetuara gjithashtu i shërbejnë edhe qëllimit për t'ia demonstruar palëve se janë dëgjuar, dhe në këtë mënyrë i kontribuojnë pranimit më të vullnetshëm të vendimit.¹² Gjithashtu, vetëm duke lëshuar një vendim të arsyetuar mund të ketë një shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë.¹³
65. Në aktvendimin e kundërshtuar, Gjykata e Apelit ka treguar shkeljet procedurale të Gjykatës Themelore, të cilat i referohen formës dhe përmbajtjes së aktgjykimit. Gjykata Supreme pajtohet me prokurorin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban të gjitha elementet e nevojshme të siç është përcaktuar me ligj¹⁴. Mangësitë në lidhje me formën e aktgjykimit me shkrim mund të korrigjohen me anë të aktvendimit të veçantë të kryetarit të trupit gjykues, duke vepruar me propozim të palëve, avokatit mbrojtës apo sipas detyrës zyrtare. Në këtë rast, këto gabime pak të rëndësishme ose gabime të padëmshme të aktgjykimit gjithashtu do të mund të korrigjoheshin edhe nga Gjykata e Apelit, sipas nenit 403 të KPP-së.

¹⁰ *Lalmahomed kundër Holandës* [2011] GjEDNi 338, par. 37.

¹¹ *Hadjianastassiou kundër Greqisë* [1992] GjEDNj 78, par. 33; *Baucher kundër Francës* [2007] GjEDNj, par. 42

¹² *Taxquet kundër Belgjikës* [2010] GjEDNi 1806, par. 91. Shih gjithashtu *Suominen kundër Finlandës* [2003] GjEDNi 330, par. 37.

¹³ *Suominen kundër Finlandës* [2003] GjEDNi 330, par. 37.

¹⁴ Ankesa e Prokurorit, e datës 4 shtator 2015, f.6-8

66. Gjykata Supreme pajtohet me prokurorin se edhe dispozitivi (faqet 6 dhe 9) edhe arsyetimi (faqet 21 – 35) i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në mënyrë të qartë tregojnë faktet dhe veprimet për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë, dhe vlerësimin e provave bazë. Më tutje, aktgjykimi përmban arsyetimin e cilësimit juridik të veprave penale, përgjegjësinë penale në lidhje me secilën akuzë dhe secilin të akuzuar. Prandaj, vlerësimi i Gjykatës së Apelit se aktgjykimit të shkallës së parë i mungon qartësia dhe arsyetimi nuk mund të aprovohet.
67. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se në parim aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban të gjitha elementet e nevojshme siç është përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale në nenin 370.
68. Për më tepër, Gjykata e Apeli nuk ka sqaruar se pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka mundur të ndryshohet në pajtim me nenin 403 të KPP-së. Nuk ka asnjë argument të vetëm në mbështetje të ekzistimit të ndonjë rrethane e cila nuk do t'ia lejonte Gjykatës së Apelit që të vendos në lidhje me meritat e lëndës. Në këtë mënyrë, është e qartë se Gjykata e Apelit i është shmangur marrjes së vendimit, e që sipas mendimit të shumicës së këtij kolegji është e papranueshme.
69. Ekziston një mospërputhje e dukshme në mes të vlerësimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme sa i përket mundësisë për të proceduar me shqyrtimin meritave të lëndës nga apeli. Prandaj, Gjykata Supreme në përputhje me nenin 398 (2) të KPP-së, ka vendosur që lënda të kthehet në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim nga një kolegji i ri.
70. Gjatë procedurës së apelit, Gjykata e Apelit përsëri do të procedojë në përputhje me dispozitat e Kapitullit XXI të Kodit të Procedurës Penale. Në veçanti, gjykata do të shqyrtojë pjesën e aktgjykimit e cila është kundërshtuar me ankesë. Përveç kësaj, gjykata do të shqyrtojë sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkeljet sipas nenit 394 (1) të KPP-së. Përfundimisht, Gjykata e Apelit do të merr vendim me arsyetim i cili do të tregojë në mënyrë të qartë bazën mbi të cilën është marrë vendimi.
71. Gjykata Supreme nuk e paragjykon rezultatin e procedurës së apelit në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit është kompetente për të vendosur nëse ky aktgjykim duhet të vërtetohet, ndryshohet, ose anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim. Megjithatë, secili vendim i Gjykatës së Apelit duhet patjetër të jetë i bazuar në vlerësimin e plotë dhe të hollësishëm të faktorëve relevant dhe të jetë i arsyetuar në mënyrë të duhur. Fatkeqësisht, kjo nuk është bërë nga Gjykata e Apelit në aktvendimin e kundërshtuar.
72. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv.